L I G J
Nr.9448, datë 5.12.2005

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8811, DATË 17.5.2001 "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË"

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 4 pika 2, pas fjalës "juristë" shtohen fjalët "jo gjyqtarë".

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5
Papajtueshmëritë

Mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është i papajtueshëm me çdo veprimtari tjetër politike, publike ose private, përveç mësimdhënies.".

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 6
Kohëzgjatja në detyrë, imuniteti dhe paga

1. Anëtarët e zgjedhur qëndrojnë në detyrë për një periudhë 5-vjeçare pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme. Anëtarët e KLD-së, të zgjedhur prej Konferencës Gjyqësore Kombëtare ose Kuvendit, e ushtrojnë detyrën e tyre me kohë të plotë. Afati i qëndrimit në detyrë i anëtarëve të zgjedhur të KLD-së fillon nga data e zgjedhjes së tyre.

2. Pas përfundimit të mandatit, anëtari i zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare rikthehet pranë gjykatës ku kryente detyrën si gjyqtar, ose me pëlqimin e tij në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel. Përjashtim nga ky rregull bën anëtari i KLD-së, që në detyrën e mëparshme gëzonte mandatin e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Ky anëtar përfiton të njëjtin trajtim si çdo anëtar i Gjykatës së Lartë, të cilit i përfundon afati kohor i qëndrimit në detyrë.

3. Pas përfundimit të mandatit, anëtari jo gjyqtar i zgjedhur nga Kuvendi rikthehet në detyrën shtetërore në pozicionin e mëparshëm, ose në pamundësi i ofrohet një pozicion tjetër i të njëjtit nivel ose i një niveli më të lartë, në përputhje me dispozitat ligjore të shërbimit civil, duke përjashtuar konkurrimin.

4. Anëtarët e KLD-së gjatë qëndrimit në këtë detyrë gëzojnë imunitet. Gjatë ushtrimit të mandatit ata mund të ndiqen penalisht vetëm me miratimin e KLD-së. Anëtari i KLD-së mund të

ndalohet ose të arrestohet vetëm nëse kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë KLD-në. Në rast se KLD-ja nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të anëtarit të tij të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë. Në rastin kur ndaj një anëtari të KLD-së vendoset fillimi i një çështjeje penale për një krim, ai pezullohet nga funksioni derisa të merret vendimi i formës së prerë.

5. Paga e anëtarit të KLD-së është 10 për qind më e ulët se paga e Zëvendëskryetarit të KLD-së.”.

Neni 4

Në nenin 12 pikat 3 dhe 4 shfuqizohen.

Neni 5

Në nenin 13 pika 1 shfuqizohet.

Neni 6

Dispozita kalimtare

1. Brenda 15 ditëve kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që preken prej tij, duhet të paraqesin pranë Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë një deklaratë me shkrim, me anë të së cilës i konfirmojnë Këshillit zgjedhjen e ushtrimit të njërës nga detyrat.

Në rast mosparaqitjeje të deklaratës, mandati i anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbaron automatikisht në mëngjesin e ditës së nesërme.

2. Në përfundim të afatit 15-ditor, Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë informon institucionet dhe publikun për zgjedhjen, si dhe merr çdo masë të nevojshme, nëse ka vend, për të koordinuar veprimet për plotësimin e numrit të vendeve të mbetura vakant, për një mandat të plotë 5-vjeçar, sipas rastit, nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare ose Kuvendi.

3. Mandati i anëtarit të tanishëm të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, që zgjedh njërën nga detyrat, përfundon në fund të afatit 5-vjeçar, nga data e fillimit të detyrës së tij si anëtar prej organit që e ka zgjedhur.”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.